



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.462/2021

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Lumni Sallauka, me bashkëpunëtoren profesionale Arta Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Sh.M, nga Peja, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. H.N nga Peja, kundër debitorit T.A sh.a., në Prishtinë, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur më ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm Cp.nr.28/20, të datës 10.11.2020, më datën **23.05.2022**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit T.A sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm Cp.nr.28/20, i datës 10.11.2020, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin e ankimuar Cp.nr.28/20, të datës 10.11.2020 e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit T.A sh.a., me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër aktvendimit Cp.nr.28/20, të datës 03.03.2020, mbi caktimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ka paraqitur ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të pranohet si e bazuar ankesa e debitorit T.A sh.a., në Prishtinë, të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cp.nr.28/20, i datës 10.11.2020, ashtu që përfundon përmbarimi sipas detyrës zyrtare pasi që dokumenti përmbarues është i pa efekt ose të nxjerri aktvendim me të cilin aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit dhe të prishet aktvendimi i ankimuar.

Në bazë të shkresave të lëndës del se kreditori nuk ka parashtruar ankesë, e as përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e debitorit, **është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori nëpërmes të autorizuarit të tij ka paraqitur propozim për përmbartim me datë 11.01.2019, ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.72/17, të datës 18.07.2017, i formës së prerë me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.3888/17, të datës 18.10.2018.

Gjykata Themelore në Pejë, duke vepruar lidhur me propozimin për përmbartim të kreditorit, me aktvendimin E.nr.4/19, të datës 28.02.2019, e ka lejuar përmbartimin.

Debitori me datën 11.03.2019, ka ushtruar prapësim kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit E.nr.4/19, të datës 28.02.2019, debitori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Pejë, me aktvendimin E.nr.04/19, të datës 10.04.2019, e ka refuzuar në tersi si të pabazuar prapësimin e debitorit T.A sh.a., në Prishtinë, i parashtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit të kësaj gjykate E.nr.04/19, të datës 28.02.2019.

Kundër këtij aktvendimi debitori me datën 19.04.2019, ka ushtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartuese, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimi të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar e debitorit dhe të priset aktvendimi i ankimuar ose Gjykata Themelore në Pejë, të shpallet inkompetent në pikëpamje territoriale në çështjen përmbartimore të kreditorit Sh.M nga Peja ndaj debitorit T.A sh.a., në Prishtinë.

Duke vendosur sipas ankesës Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.2525/2019, të datës 05.09.2019, e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit T.A sh.a., në Prishtinë, dhe e ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë E.nr.04/2019, i datës 10.04.2019 dhe çështjen e ka kthyer të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë Gjykata Themelore në Pejë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin tani të ankimuar E.nr.283/19 të datës 22.10.2019, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) k) dhe m) të LPK, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe

ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-ës.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.72/17, i datës 18.07.2017, (i cili është ndryshuar vetëm sa i përket kamatës nga Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.3888/17, të datës 18.10.2018 ), i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 18.10.2018 dhe i ekzekutueshëm me datën 19.11.2018, në bazë të cilit gjykata ka caktuar përmbarimin është dokument përmbarues dhe se kjo parashihet në nenin 22 par.1 pika 1.1 të LPP-ës ku ceket “*dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i gjykatës...*”, çka paraqet bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 par.1 dhe 27 par.1 të këtij ligji ku ceket se “*dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se ka shkelje të dispozitave ligjore me rastin e lejimit të përmbarimit, nuk qëndrojnë.

Duke e shqyrtuar aktvendimin e ankimuar në raport me të gjitha pretendimet ankimore, Gjykata e Apelit ka gjetur se të njëjtat janë të pa bazuara. Me nenin 71 të LPP-së, janë paraparë shkaqet të cilat kundërshtimin e paraqitur ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarimit do ta bënin të bazuar, andaj duke pasur parasysh se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga arsyet e parapara në nenet e lartcekura, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par. 1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.462/2021, datë 23.05.2022**

**Gjyqtari,**

